

KAPITULLI VII. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

VII.1. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Nxitja dhe mbështetja për mirëfunksionimin e sistemit të brendshëm të pagesave në Shqipëri është një nga objektivat dhe detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë. Për të përmbushur këtë detyrë, Banka e Shqipërisë zbaton të paktën tre përjasje të ndryshme: (i) luan rol operacional në ofrimin e sistemeve, (ii) kryen veprimtari mbikëqyrëse mbi sistemet, dhe (iii) vepron si katalizator/reformator për sistemin kombëtar të pagesave. Këto përjasje janë plotësuese të njëra-tjetrës, duke bashkëvepruar ndërmjet tyre.

VII.1.1. TREGUES STATISTIKORË TË SISTEMIT TË PAGESAVE GJATË VITIT 2010

Në Republikën e Shqipërisë, klerimi dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave, në monedhën kombëtare Lek, realizohet nëpërmjet dy sistemeve të pagesave: "Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS" dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH". Të dy sistemet e pagesave administrohen dhe operohen nga Banka e Shqipërisë, në rolin e saj operacional në ofrimin e infrastrukturës së tregut. Në fund të vitit 2010, të gjitha bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta për shlyerje në sistemin AIPS, nga të cilat, 15 banka janë gjithashtu pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në sistemin AECH¹.

- *SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE - AIPS*

Gjatë vitit 2010, sistemet e pagesave kanë reflektuar siguri dhe eficiencë, karakteristika të domosdoshme për funksionimin normal të tyre. Një volum prej 80,356 transaksionesh u shlye në sistemin AIPS gjatë vitit 2010, me një vlerë totale të likuiditetit të qarkulluar në sistem prej 4,437 miliardë lekësh. Kundrejt vitit 2009, volumi i transaksioneve të shlyera gjatë vitit 2010, rezulton të jetë rritur me 44%, ndërkohë që vlera e transaksioneve të shlyera është ulur me 6%. Ndikim të ndjeshëm në vlerën e transaksioneve të shlyera në sistem gjatë vitit 2010, ka patur reduktimi i transaksioneve të Bankës së Shqipërisë në letrat me vlerë në lekë të qeverisë.

¹ Gjatë vitit 2010, Banka e Shqipërisë ka përfunduar procedurat dhe testimet e nevojshme për anëtarësimin e Bankës Veneto në sistemin AECH. Duke filluar nga muaji shkurt 2011, procedurat për anëtarësimin e Bankës Veneto kanë përfunduar, duke bërë që të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri, të jenë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në sistemin e klerimit të pagesave me vlerë të vogël AECH.

Tabelë 1. Ecuria e transaksioneve në sistemin AIPS për periudhën 2007-2010.

Sistemi AIPS	2007	2008	2009	2010
Numri i transaksioneve	45,480	56,717	55,701	80,356
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,745	5,146	4,718	4,437
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	82	91	85	55

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një pasqyrë më e detajuar e llojeve të transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2010, si dhe pesha e tyre ndaj totalit të aktivitetit, paraqitet në tabelën në vijim. Nga transaksionet e procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2010, rreth 68% të volumit të transaksioneve e zënë pagesat që pjesëmarrësit shlyejnë me njëri-tjetrin për llogari të klientëve të tyre, me një rritje prej 85% krahasuar me të njëjtin tregues për vitin 2009. Kjo rritje është rrjedhojë e projektit për automatizimin e pagesave të Thesarit nga Ministria e Financave, duke zënë një peshë prej 50% në numër dhe 31% në vlerë, kundrejt totalit të pagesave të klientëve në sistemin AIPS.

Tabelë 2. Llojet e transaksioneve në sistemin AIPS.

Lloji i transaksioneve në AIPS	Volum		Vlerë (miliardë lekë)	
	Numri i transaksioneve	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione/instrumente financiare të BSH	2,758	3.4 %	2,130	48 %
Transferta cash për/nga emisioni	8,770	10.9 %	219	4.9 %
Pagesa ndërbankare (MT202)	8,084	10.1 %	833	18.8 %
Pagesa për klientët (MT103)	54,454	67.8 %	729	16.5 %
Shlyerje neto për sistemet e klerimit	6,290	7.8 %	526	11.8 %
Totali	80,356	100 %	4,437	100 %

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Referuar vlerës së transaksioneve të shlyera në AIPS, qarkullimin më të lartë të likuiditetit, rreth 48% ndaj totalit, e zënë transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, për përmbushjen e objektivave të saj ligjorë kundrejt një peshe prej 57% që zinte në vitin 2009. Rënia në vlerën e likuiditetit të qarkulluar në sistemin AIPS gjatë vitit 2010, për transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, kryesisht është rezultat i reduktimit të transaksioneve të Bankës së Shqipërisë në letrat me vlerë të qeverisë. Në zërin "shlyerje neto për sistemet e klerimit" përfshihen transaksionet për shlyerje neto të rezultateve nga sistemet e klerimit, si: klerimi i pagesave me vlerë të vogël në sistemin AECH, klerimi i çeqeve bankare dhe personale në lekë, shlyerjet neto për emetimin/maturimin e letrave me vlerë të qeverisë dhe shlyerjet neto të rezultateve të pagesave në lekë me karta VISA dhe MasterCard, shërbime për të cilat Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit shlyerës.

Treguesi i përqendrimit reflekton peshën që zënë 4 bankat më aktive në sistemin AIPS, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem. Siç shihet dhe nga tabela 3, gjatë vitit 2010 Banka e Shqipërisë (përfshirë pagesat e Thesarit) ka iniciuar rreth 50% në numër dhe 54% në vlerë të transaksioneve, kundrejt totalit të aktivitetit në sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	Volum transaksionesh		Vlerë transaksionesh (miliardë lekë)	
	Peshë/Totalit		Peshë/Totalit	
4 banka	23 %		39 %	
12 bankat e tjera	27 %		15 %	
Banka e Shqipërisë	50 %		54 %	
Totali (vlerë absolute)	80,356		4,437	

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 3. Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS.

Përdorimi i kredisë brenda ditës (ILF) është një instrument eficient që bankat pjesëmarrëse në sistemin AIPS mund ta përdorin për menaxhimin e likuiditetit gjatë aktivitetit operacional brenda ditës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vërehet një rritje në numrin e kredive të disbursuara (përdorimit të ILF-ve) në masën 34%, ndërkohë që ka rënë me 37% vlera e likuiditetit brenda ditës të disbursuar gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar nevoja më të pakta për likuiditet nga ana e bankave që përmbushin kushtet për garantimin e likuiditetit shtesë. Rënia në vlerën e kredisë brenda ditës të disbursuar, kryesisht, është rezultat i ndryshimit të politikës së Bankës së Shqipërisë për rritjen e limitit (nga 20% në 40%) të përdorimit të rezervës së detyruar në lekë nga bankat për nevoja likuiditeti gjatë ditës, me qëllim garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit AIPS.

Kredi brenda ditës (ILF)	2007	2008	2009	2010
Numri i transaksioneve	675	579	207	278
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	218	221	121	75
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	322	382	582	270


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Kredia brenda ditës për pjesëmarrësit në sistemin AIPS.

Shpërndarja e nevojave për likuiditet brenda ditës të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, gjatë gjithë vitit 2010, pasqyrohet në grafikun në vijim. Vërehet se muaji korrik rezulton si periudha me kërkesa më të mëdha për likuiditet, periudhë në të cilën Banka e Shqipërisë ka disbursuar rreth 26% të vlerës së kredisë së disbursuar gjatë gjithë vitit.

• **SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH**

Në sistemin AECH procesohen dhe klerohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1 milion lekë. Një total prej 332,777 urdhërpagesash u kleruan në sistemin AECH gjatë vitit 2010, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 130 mijë lekë. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AECH janë procesuar rreth 1,330 pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 176 milionë lekë. Kundrejt vitit 2009, volumi i pagesave të kleruara gjatë vitit 2010, rezulton të jetë rritur rreth 225%, ndërkohë që vlera e transaksioneve të kleruara është rritur me 185%.



Tabelë 5. Ecuria e aktivitetit në sistemin AECH për periudhën 2007-2010.

Sistemi AECH	2007	2008	2009	2010
Numri i transaksioneve	71,857	113,682	102,304	332,777
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	12.01	17.61	15.46	43.98
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.17	0.15	0.15	0.13

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç vihet re nga tabela, ka patur një rritje të konsiderueshme të numrit të urdhërpagesave të procesuara në sistemin AECH, kundrejt aktivitetit të viteve të kaluara. Kjo rritje vjen si rrjedhojë e finalizimit të projektit (Mars 2010) për automatizimin e pagesave ndërmjet Sistemit të Thesarit AMoFTS pranë Ministrisë së Financave dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH pranë Bankës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës dhjetëmuajore të funksionimit të ndërfaqes elektronike midis sistemeve, u mundësua ekzekutimi i një fluksi të lartë pagesash, të iniciuara nga Ministria e Financave në favor të klientëve përfitues pranë bankave pjesëmarrëse në sistem, duke përbërë rreth 74% të volumit dhe 71% të vlerës vjetore të pagesave në sistemin AECH.

Treguesi i përqendrimit reflekton peshën që zënë 4 bankat më aktive në sistemin AECH (përfshirë Bankën e Shqipërisë si pjesëmarrëse në sistem), kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem.

Tabelë 6. Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH.

	Volum transaksionesh	Vlerë transaksionesh (miliardë lekë)
Sistemi AECH	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
4 banka	14 %	15 %
12 bankat e tjera	12 %	14 %
Ministria e Financave (Thesari)	74 %	71 %
Totali (vlerë absolute)	332,777	43.98

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pagesat e kleruara në sistemin AECH, procesohen në dy seksione gjatë ditës së punës (seksioni 1 - nga ora 09.00 deri në 11.00, dhe seksioni 2 - nga ora 12.00 deri në 14.30). Pas përfundimit të secilit seksion, pagesat shlyhen për rezultat neto në sistemin AIPS.

Tabelë 7. Shpërndarja e pagesave në sistemin AECH sipas seksioneve të klerimit gjatë vitit 2010.

Sistemi AECH	Seksioni		Viti
	I	II	2010
Numri i transaksioneve	162,167	170,610	332,777
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	22.17	21.81	43.98
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.136	0.128	0.13

Burimi: Banka e Shqipërisë.

VII.1.2. INSTRUMENTET E PAGESAVE

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2010, numri total i llogarive bankare të klientëve, të vlefshme për të kryer pagesa në lekë apo në


valutë të huaj, është rreth 2.5 milionë llogari klientësh, me një rritje prej 17% krahasuar me fundin e vitit 2009. Rreth 91% e totalit të llogarive janë llogari individuale dhe mbi 99% e totalit të llogarive i përkasin klientëve rezidentë.

Tabelë 8. Numri i llogarive të klientëve në sistemin bankar, në 31 dhjetor 2010.

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2008	2009	2010	2008	2009	2010
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,573,830	2,086,143	2,446,495	11,108	15,034	27,368
1-llogari të rezidentëve (a+b) (%)	99%	99%	99%	97%	97%	97%
a - individuale (%)	91%	92%	93%	65%	66%	69%
b - kompani (%)	9%	8%	7%	35%	34%	31%
2-llogari të jorezidentëve (c+d) (%)	1%	1%	1%	3%	3%	3%
c - individuale (%)	96%	94%	93%	88%	80%	78%
d - kompani (%)	4%	6%	7%	12%	20%	22%

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Nga totali i llogarive të klientëve në fund të vitit 2010, rreth 27 mijë llogari janë të aksesueshme online nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 82% në krahasim me fundin e vitit 2009. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të këtij treguesi gjatë vitit 2010, niveli i aksesueshmërisë online të llogarive bankare nga klientët vazhdon të mbetet ende në nivele shumë të ulëta. Referuar raportimeve nga bankat gjatë vitit 2010, grafiku 2 në vijim reflekton peshën e transaksioneve të klientëve në sistemin bankar, sipas llojit të transaksionit (cash/jo-cash).



Nga tabela 9 në vijim vërehet se pagesat në monedhën kombëtare zënë një peshë prej 86% në volum dhe 54% në vlerë, kundrejt totalit të pagesave të klientëve. Gjithashtu, vihet re se pagesat e klientëve vazhdojnë të dominojnë në formë letër (rreth 80%), përkundëjt një rritjeje të moderuar të pagesave në formë elektronike (rreth 9%).

Tabelë 9. Pësja e pagesave të klientëve në sistemin bankar sipas instrumentit të pagesës.

Shërbime pagesash për klientët	Pagesa në Lekë		Pagesa në Valutë		Totali i pagesave	
	Numër	Vlerë (miliardë lekë)	Numër	Vlerë (miliardë lekë)	Numër	Vlerë (miliardë lekë)
1 janar - 31 dhjetor 2010						
I. Transferta kreditimi të klientëve nga të cilat:	81.6%	95.1%	78.2%	93.3%	81%	94%
1. Transfertë krediti formë letër	97.8%	97.4%	94.3%	96.8%	97%	97%
2. Transfertë krediti "e-banking"	2.2%	2.6%	5.7%	3.2%	3%	3%
II. Pagesa me karta në POS nga të cilat:	5.8%	0.2%	15.5%	0.3%	7%	0%
1. Pagesa me karta debiti	63.5%	48.8%	55.6%	37.1%	61%	42%
2. Pagesa me karta krediti	36.5%	51.2%	44.4%	62.9%	39%	58%
III. Debitimi Direkt	12.0%	2.3%	4%	5.0%	11%	4%
IV. Çeqe	0.7%	2.4%	2.3%	1.5%	1%	2%
Totali i Pagesave (I+II+III+IV)	6,327,342	1,825	1,049,697	1,573	7,377,039	3,398

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").


Në fund të vitit 2010, në Republikën e Shqipërisë operojnë 16 banka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash në 529 degë/agjenci bankare në të gjithë vendin. Aktualisht, janë 14 bankat e licencuara si emetuese kartash, që ofrojnë shërbimin e tërheqjes cash nga bankomatet (pajisjet ATM). Nga bankat që emetojnë karta, vetëm 7 banka janë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash, duke ofruar shërbimin e pranimit të pagesave me karta në pikat e shitjeve, nëpërmjet pajisjeve POS të vendosura në dyqane, restorante, hotele apo dhe në qendra tregtare.

Tabelë 10. Numri i pajisjeve ATM dhe POS në 31 dhjetor 2010, krahasuar me vitet 2008 dhe 2009.

Përshkrimi	2008	2009	2010
Makina ATM (Automated Teller Machines) prej të cilave:	642	741	771
1 - ATM me funksion tërheqje cash	642	741	771
2 - ATM me funksion urdhër-transferta	59	66	62
3 - ATM me funksion depozitim cash	73	74	84
Terminale POS (Point of Sale) prej të cilave:	2,953	4,370	4,903
1 - terminale POS me funksion tërheqje cash	907	1,290	111
2 - terminale pagesash EFTPOS	2,915	4,320	4,846
Terminale për përdorimin e parasë elektronike	-	-	-

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Gjatë vitit 2010, numri i pajisjeve ATM është rritur me 4% krahasuar me fundin e vitit 2009, ndërkohë që është zgjeruar rrjeti i pajisjeve POS me një rritje prej 12% krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Nga raportimet e bankave rezulton se pajisjet ATM dhe POS janë vendosur në rajonet e zhvilluara të vendit si dhe në qendrat industriale. Nga grafiku 3 vihet re se shtrirja më e madhe e infrastrukturës, rreth 53% e bankomateve dhe 78% e terminaleve POS, është e vendosur në zonën e Tiranës (raportimi nga bankat i referohet ndarjes territoriale të vendit sipas degëve të Bankës së Shqipërisë).



Kartat janë instrumente pagesash që kanë gjetur përdorim në Shqipëri, ndonëse shkalla e përdorimit të tyre është ende e ulët krahasuar me treguesit e vendeve të tjera të rajonit. Gjatë vitit 2010, vihet re një rritje prej 23% e numrit të kartave në qarkullim, krahasuar me fundin e vitit 2009.

Numri i kartave sipas funksioneve	2008	2009	2010
Karta me funksion <i>cash-i</i> dhe pagese prej të cilave:			
1- Karta debiti	482,072	543,141	667,548
2- Karta krediti	15,931	23,844	27,300
Karta me funksion "para elektronike"	-	-	-
Numri total i kartave në qarkullim	498,003	566,985	694,848


Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Tabelë 11. Numri i kartave në qarkullim në 31 dhjetor 2010, krahasuar me vitet 2008 dhe 2009.

Referuar raportimeve të bankave, kartat e debitit zënë rreth 96% ndaj totalit të kartave në qarkullim. Përsa i përket llojit të kartës dhe operatorëve që ofrojnë shërbimin e procesimit të kartave, peshë më të madhe zënë kartat VISA, rreth 83% ndaj totalit, të ndjekura nga kartat Master Card. Peshë më të vogël zënë kartat Maestro dhe American Express. Vetëm dy banka emetojnë karta lokale të cilat zënë rreth 2% ndaj totalit të kartave në qarkullim.

Nga totali i llogarive të klientëve të raportuara nga bankat, rreth 29% e llogarive mund të aksesohen në distancë, nëpërmjet përdorimit të një karte debiti ose krediti. Ofrimi i shërbimit të pagesave apo tërheqjes *cash* nga llogaritë e tjera, kërkon domosdoshmërisht praninë fizike të klientëve në sportelet e bankave.

Grafik 4. Peshë e kartave të pagesave sipas llojit, deri në fund të vitit 2010.



Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Shpërndarja e kartave sipas gjinisë dhe moshës së kartëmbajtësit paraqitet grafikisht në tabelën në vijim.




Tabela në vijim reflekton llojet e transaksioneve të kryera me karta bankare (debiti/krediti), në volum dhe vlerë, krahasuar me të dhënat për vitin e kaluar.

Tabelë 12. Transaksione me karta pagesash gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009.

Transaksione me karta sipas llojit të transaksionit	Volum		Vlerë (milionë lekë)	
	2009	2010	2009	2010
1- ATM tërheqje cash	8,717,982	9,877,583	96,117.27	100,057.91
2- ATM depozitime	91	47	2.97	0.23
3- Urdhër transfertë nëpërmjet ATM	366	260	10.02	6.31
4- Tërheqje cash në terminale POS	2,647	1,654	453.86	358.22
5- Pagesa me karta në terminale POS prej të cilave:	403,214	527,411	5,321.72	7,438.30
- pagesa me karta debiti	252,780	322,230	2,565.67	3,151.13
- pagesa me karta krediti	150,434	205,181	2,756.05	4,287.17
Totali i transaksioneve me karta	9,124,300	10,406,955	101,905.3	107,860.96

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2010, në total u procesuan rreth 10.5 milionë transaksione me karta (ATM dhe POS), me një qarkullim total prej 108 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 95% e përbëjnë tërheqjet cash nga ATM-të dhe vetëm 5% janë pagesa klientësh me karta në POS-e, tregues ky i një ekonomie ende me përdorim të lartë të cash-it.

Home Banking është një shërbim bankar që po gjen përdorim gjithnjë e më rritje, duke i mundësuar klientëve aksesimin në distancë të llogarive bankare, nëpërmjet një linje interneti, telefoni apo një software-i që banka i

vë në dispozicion klientit të saj. Për herë të parë këtë shërbim e ofroi Banka Amerikane e Shqipërisë në vitin 2005, ndërsa në vitin 2010 ky shërbim ofrohet nga 11 banka në Shqipëri. Gjatë vitit 2010 janë raportuar rreth 163 mijë transaksione elektronike "Home Banking" për të gjithë sistemin bankar, me një vlerë totale prej 92 miliardë lekësh, që zënë rreth 2% në volum dhe në vlerë kundrejt totalit të pagesave të klientëve.

Transaksione Home Banking	Numri i bankave	Numër transaksionesh	Vlerë transaksionesh (milionë lekë)
2005	1	15,706	15,908
2006	1	19,096	16,834
2007	3	42,447	48,492
2008	6	88,261	63,240
2009	10	136,482	78,156
2010	11	162,385	91,274

Tabelë 13. Ecuria e transaksioneve "home banking" në vite.

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

VII.1.3. ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË SI MBIKËQYRËSE DHE REFORMATORE E SISTEMIT KOMBËTAR TË PAGESAVE

Roli i bankës qendrore në reformimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë po punon për ndërtimin e një sistemi kombëtar pagesash të sigurt dhe eficient, në mbështetje të zhvillimeve më të fundit të tregut financiar në vend, bazuar në praktikën më të mira të bankave të tjera qendrore. Banka e Shqipërisë ka filluar një projekt binjakëzimi me Bankën e Italisë, ku zhvillimi dhe mbikëqyrja e sistemit të pagesave zë një peshë mjaft të rëndësishme. Projekti synon, përveç të tjerave, ngritjen e kapaciteteve dhe përafrimin e kuadrit rregullativ dhe operacional të funksionimit të sistemeve të pagesave në Shqipëri, krahasuar me ato të vendeve të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2010, u finalizua draftimi i projektligjit "Për sistemet e pagesave" dhe komentari shpjegues, një dokument i rëndësishëm që synon të shpjegojë disa koncepte ende të reja për sistemin kombëtar të pagesave, si dhe një saktësim më të detajuar të rolit dhe të detyrave të Bankës së Shqipërisë në lidhje me zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në vend. Ky projektligj përbën një hap të mëtejshëm, tepër të rëndësishëm në procesin për përafrimin e vazhdueshëm të legjisllacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën bankare dhe financiare, parashikuar gjithashtu edhe në nenet 70 dhe 89 të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit (MSA) midis Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian.

Në terma ndërkombëtarë, bankat qendrore duhet të kenë një juridiksion të veçantë mbi infrastrukturën e shlyerjes së instrumenteve financiare ("post-trading"), si pjesë e mandatit të tyre të përgjithshëm për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave. Për këtë arsye, projektligji synon të rregullojë dhe të mbikëqyrë sistemin e pagesave në tërësi, duke përfshirë edhe institucione të tilla si: shtëpitë e klerimit të titujve, sistemet e shlyerjes së tyre dhe të tjerë


si për shembull: CSD, CCP. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të bashkëpunojnë për përcaktimin e roleve dhe detyrave në funksion të mbikëqyrjes së sistemeve të klerimit dhe të shlyerjes së titujve.

Në muajin dhjetor 2010, projektligji “Për sistemet e pagesave” së bashku me relacionin shpjegues dhe tabelën e përputhshmërisë me *acquis communautaire*, janë propozuar për shqyrtim pranë Ministrisë së Financave.

Pas një bashkëpunimi disaveçar midis Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe sistemit bankar, në datë 1 mars 2010 u realizua komunikimi live ndërmjet Sistemit të Thesarit AMoFTS pranë Ministrisë së Financave dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH pranë Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes elektronike. Vlen për t’u përmendur që, në kuadrin e zbatimit të skemës së re të automatizimit të pagesave të Thesarit, Ministrisë së Financave iu mundësua monitorimi në kohë reale i aktivitetit në llogaritë e saj në sistemin AIPS pranë Bankës së Shqipërisë, duke i shërbyer një administrimi sa më eficient të fondeve nga ana e saj. Projekti konsiston në procesimin automatik të pagesave në lekë të iniciuara nga degët e Thesarit, në favor të individëve apo institucioneve të tjera përfituese të fondeve publike. Pjesa e grumbullimit të të ardhurave për Thesarin (nga publiku) aktualisht realizohet nëpërmjet bankave, ku në fund të ditës secila bankë bën transferimin në total të fondeve të arkëtuara cash në favor të llogarisë kryesore të qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, gjatë këtij viti puna është fokusuar në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturave të nevojshme për shlyerjen e instrumenteve elektronike të pagesave (kartat bankare). Në korrik 2010, u finalizua projekti për shlyerjen e pagesave në lekë me karta MasterCard dhe Maestro, nëpërmjet sistemit të pagesave AIPS, shërbim që i ofrohet kompanisë MasterCard, pas një përvoje disaveçare në ofrimin e të njëjtit shërbim për kompaninë Visa.

Grafik 6. Monedha në qarkullim (në 000 lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

VII.2. EMISIONI I MONEDHËS

• MONEDHA NË QARKULLIM

Monedha në qarkullim në fund të vitit 2010 arriti në vlerën rreth 202.36 miliardë lekë, në krahasim me rreth 216.74 miliardë lekë në fund të vitit 2009. Edhe këtë vit, rritja më e madhe u konstatua në tremujorin e katërt.


• STRUKTURA E MONEDHËS NË QARKULLIM

Kartëmonedha

Struktura e kartëmonedhës në qarkullim² u karakterizua nga një balancim i prerjeve në raport me pakësimin e monedhës në qarkullim, ku përsëri


² Ky tregues përfaqëson kartëmonedhat dhe monedhat me kurs ligjor, që kanë dalë nga sportelet e Bankës së Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

peshën më të madhe e kanë prerjet e mëdha. Kjo, kryesisht e diktuar nga kërkesat e bankave tregtare për të përballuar fluksin e pagesave dhe mbushjen e bankomateve me prerjet e lartpërmendura. Gjatë vitit 2010, pati një rritje të ndjeshme në qarkullim të kartëmonedhës 2000 lekë.




MONEDHA METALIKE

Struktura e monedhës metalike edhe këtë vit vazhdoi të orientohet nga një rritje e peshës së prerjeve të mëdha 50 dhe 100 lekë. Një nga faktorët kryesorë që ndikoi në këtë rritje ishte përdorimi i këtyre monedhave për të zëvendësuar kartëmonedhën e prerjes 100 lekë e cila u hoq nga qarkullimi në 31 dhjetor 2010.



MONEDHA METALIKE KUNDREJT KARTËMONEDHËS

Në fund të vitit 2010, raporti i përgjithshëm midis vlerës së monedhave metalike ndaj kartëmonedhave rezultoi më i lartë se vitin e kaluar. Zëvendësimi gradual i kartëmonedhës së prerjes 100 lekë me monedha metalike dhe kërkesat për monedha metalike nga ana e tregtisë me pakicë dhe kryesisht e supermarketeve dhe ipermarketeve të çelura rishtas, ishin faktori kryesor që raporti të ketë një tendencë rritëse, megjithë shtimin e dukshëm të kartëmonedhës.



• TREGUES TË QARKULLIMIT TË PARASË

Kartëmonedhat dhe monedhat në qarkullim

Në fund të vitit 2010 rezultuan në qarkullim:

- 153,433,328 copë kartëmonedha,
- 116,098,253 copë monedha metalike.

Vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim

Vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim në fund të vitit 2010 arriti në 1227 lekë, nga 1063 lekë që ishte në fund të vitit 2009.

Paraja në qarkullim kundrejt M2

Në fund të vitit 2010, raporti i parasë në qarkullim ndaj agregatit M2 ishte 34.57%, ndërkohë që në fund të vitit 2009 i njëjti raport ishte 37.5%.

Koeficienti i kthimit të parasë³

Koeficienti i kthimit të parasë në Bankën e Shqipërisë, për vitin 2010, rezultoi 0.596 ndërkohë që ky koeficient për vitin 2009 ishte 0.593. Kjo tregon se gjatë vitit 2010 bankat e nivelit të dytë, në raport me paranë në qarkullim, kanë kthyer më shumë para pranë arkave të Bankës së Shqipërisë.

Cilësia e monedhës në qarkullim

Në zbatim të standardeve bashkëkohore dhe shtimit të shpejtë të numrit të bankomateve të bankave të nivelit të dytë, gjatë vitit 2010 Banka e Shqipërisë tërhoqi nga qarkullimi rreth 23,534 milionë copë kartëmonedha të papërshtatshme për përdorim duke i zëvendësuar ato me kartëmonedha të përshtatshme, ku një pjesë e konsiderueshme të sasisë së tërhequr e përbëjnë emisionet e para vitit 1996. Në fund të vitit 2010, emisionet e para vitit 1996 në qarkullim zënë vetëm 1% të kartëmonedhës mesatare në qarkullim.

Kartëmonedhat e reja të hedhura në qarkullim në vitin 2010, përfaqësojnë 15.32% të mesatares totale të kartëmonedhave në qarkullim.

VII.3. PUNA KËRKIMORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Materialet studimore të Departamenti të Kërkimeve gjatë vitit 2010 u fokusuan kryesisht në studimin e çështjeve të politikës monetare dhe të politikës fiskale, çështje të stabilitetit financiar, të modelit të ri të rritjes ekonomike, si dhe në studimin e sektorit të jashtëm.

Departamenti i Kërkimeve, nëpërmjet vënies në përdorim të njohurive dhe punëve studimore disaveçare mbi ekonominë shqiptare, ka kontribuar në debatet për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare. Kështu edhe gjatë vitit 2010, me anë të modelit MEAM dhe modeleve të tjera satelitore jashtë tij, është bërë i mundur vlerësimi i ecurisë së ardhshme të disa treguesve të rëndësishëm makroekonomikë të ekonomisë shqiptare, si dhe analiza e skenarëve të ndryshëm të rrezikut. Ndër rreziqet e analizuar përmendim ato të kursit të këmbimit, të goditjeve nga ana e ofertës dhe kërkesës, efektit të politikës fiskale etj.

Gjithashtu, gjatë vitit 2010 është ndërtuar dhe vlerësuar një model strukturor, me qëllim analizimin e politikës monetare në Shqipëri. Ky model është një model mjaft i përshtatshëm për ekonominë shqiptare pasi merr në konsideratë të gjitha karakteristikat e saj dhe pasqyron efektin e politikës monetare në treguesit kryesorë makroekonomikë si: prodhimi, inflacioni, kursi i këmbimit dhe papunësia.

Në drejtim të stabilitetit financiar është punuar për ndërtimin e një modeli DSGE, bazuar kryesisht në dy faktorë prodhimi, punën dhe kapitalin. Ndërtimi

³ Ky tregues llogaritet për çdo prerje në copë si raporti midis arkëtimeve me gjendjen mesatare të monedhës në qarkullim për një periudhë të caktuar.

i këtij modeli ka për qëllim përfshirjen e stabilitetit financiar në modelin ekzistues makroekonomik si dhe gjetjen e niveleve ekuilibër për variablat e përfshira. Gjithashtu janë realizuar dy punime, të cilat matin rrezikun indirekt të kredisë dhe efektin e treguesve makroekonomikë në nivelin e kredive me probleme. Një tjetër fokus ka qenë vlerësimi i një lidhjeje të mundshme jolineare midis inflacionit dhe zhvillimit financiar në vendin tonë, duke marrë parasysh edhe ndikimin e variablave të tjerë në inflacion si: shpenzimet qeveritare, tregtia ndërkombëtare etj.

Studimi mbi llogaritjen e *benchmark*-ut të deficitit tregtar dhe qëndrueshmërinë e llogarisë korrente, shërben si bazë referimi për politikën ekonomike mbi ekuilibrin e bilancit të jashtëm të ekonomisë. Një tjetër material i fokusuar në sektorin e jashtëm ka patur për qëllim vlerësimin e potencialeve të shkëmbimeve tregtare me partnerët tregtarë kryesorë të Shqipërisë, me fokus në marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe Bashkimin Evropian. Së fundi, nëpërmjet një tjetër studimi mbi aglomerimin ekonomik dhe krijimin e sinergjive sektoriale në Evropën Juglindore, kemi arritur në konkluzionin se në një rajon të integruar në hapësirë dhe në praktika ekonomike, rritja ekonomike ndikohet më shumë nga të ardhurat nga tregtia dhe nga investimet e huaja.

Gjithashtu janë kryer studime të ndryshme lidhur me ecurinë e rritjes ekonomike. Janë vlerësuar cilët janë përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike në Shqipëri, duke arritur në rezultatin se produktiviteti total i faktorëve të prodhimit është kontribuesi kryesor i rritjes ekonomike. Një tjetër punim me fokus rritjen ekonomike, ka analizuar efektin pozitiv të sektorit të turizmit shqiptar në rritjen ekonomike.

Një tjetër çështje e studiuar në punët kërkimore është vlerësimi i efektit të politikës fiskale diskrecionare në çmime, normat e interesit dhe rritjen ekonomike; si dhe në ndryshimin e mundshëm midis politikës së rritjes së shpenzimeve dhe asaj të uljes së taksave duke vlerësuar multiplikatorët përkatës të tyre. Gjithashtu është vlerësuar edhe qëndrueshmëria e politikës fiskale në Shqipëri, si dhe përcaktimi i një rregulli të përshtatshëm fiskal për vendin tonë. Për vetë rëndësinë që kanë dërgesat e emigrantëve në vendin tonë, janë studiuar përcaktuesit makroekonomikë të tyre, me synim hartimin e politikave ekonomike dhe një politike për tërheqjen e këtij fluksi të rëndësishëm financimi.

- *PUBLIKIMET*

Punët kërkimore dhe materialet e diskutimit të Bankës së Shqipërisë publikohen në faqen zyrtare të saj, nën kategorinë “Publikime/Kërkime dhe Materiale Diskutimi”, ndërsa pjesa e artikujve publikohen me frekuencë gjashtëmujore edhe në Buletinin e Bankës së Shqipërisë. Që prej vitit 2009, Departamenti i Kërkimeve ka filluar publikimin e revistës me frekuencë gjashtëmujore “Të rejtat shkencore në Bankën e Shqipërisë”. Ky material ka për qëllim dhënien e informacionit në lidhje me materialet e prezantuara tek “Seria e Seminareve të së Premtes”, materialet dhe artikujt që kanë përfunduar dhe janë në proces.

- **AKTIVITETET E ZHVILLUARA**

Më 3 maj 2010 u zhvillua në Berat, Tryeza Shkencore “Rritja ekonomike në Shqipëri – Nevoja për një model të ri”, e organizuar nga Departamenti i Kërkimeve. Në këtë aktivitet pati një pjesëmarrje të gjerë nga akademika, nga Banka e Shqipërisë dhe institucione ndërkombëtare si Banka Botërore, FMN dhe USAID. Studimet dhe diskutimet e prezantuara gjatë kësaj tryeze shkencore u fokusuan mbi modelin aktual të rritjes ekonomike; mbi tregun e kapitalit në modelin ekonomik në të ardhmen dhe mbi rolin e bujqësisë dhe teknologjisë në modelin e ri të rritjes, duke qenë të vëmendshëm edhe ndaj eksternaliteteve negative mjedisore të rritjes ekonomike. Debati për modelin e ri të rritjes ekonomike do të vazhdojë në seri të tjera të këtij aktiviteti, me grupe të tjera interesi, duke shpresuar që diskutimet e mendimet të kthehen në rekomandime konkrete.

Departamenti i Kërkimeve për të katërtin vit radhazi, më 18-19 nëntor 2010, zhvilloi takimin rajonal me temë “Kërkimet Ekonomike në Evropën Juglindore”. Ky aktivitet ka si qëllim kryesor përmirësimin e mëtejshëm të kërkimit ekonomik në rajon dhe zgjerimin e njohurive të bankave qendrore të rajonit mbi karakteristikat dhe zhvillimet ekonomike specifike të vendeve tona. Çështjet kryesore të trajtuara kishin të bënin me krizat globale dhe sektorët financiarë e makroekonomikë të ekonomive të Evropës Juglindore; rregullimet e zhbalancimeve të brendshme e të jashtme dhe nevoja për përpjekje të vazhdueshme nëpërmjet reformave strukturore me qëllim nxitjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Edhe gjatë vitit 2010, në vijim të punës së nisur prej disa vitesh, Departamenti i Kërkimeve vazhdon të zhvillojë “Serinë e Seminareve të së Premtes”. Gjatë këtij viti u prezantuan gjithsej 13 punime nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, nga banka të tjera qendrore si dhe përfaqësues akademikë. Ky aktivitet përbën një mundësi të mirë për të gjithë kërkuesit për të diskutuar dhe prezantuar punimet e ndryshme, si empirike ashtu dhe teorike.

VII.4. AKTIVITETET STATISTIKORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë është një ndër agjencitë kryesore statistikore në vend, së bashku me Institutin e Statistikave, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Sipas Programit të Statistikave Zyrtare⁴, Banka e Shqipërisë ka detyrimin të prodhojë dhe publikojë statistika monetare dhe statistika të bilancit të pagesave. Ligji “Për statistikat zyrtare”⁵ dhe Ligji “Për Bankën e Shqipërisë”⁶ i japin Bankës së Shqipërisë të drejtën për të mbledhur informacion për përpunim statistikor nga të gjitha njësitë statistikore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

⁴ Programi i Statistikave Zyrtare 2007-2011, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendim nr.153, datë 31.01.2008.

⁵ Ligji ‘Për statistikat zyrtare’ nr. 9180, datë 05.02.2004.

⁶ Ligji ‘Për Bankën e Shqipërisë’ nr. 8269, datë 23.12.1997.

Tabelë 14. Statistika të hapësirës 'Statistika' në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

	Numri i tabelave	Numri i treguesve
Statistika periodike të Bankës së Shqipërisë	91	3,021
Arkiva	17	126
Statistika të Ministrisë së Financave	5	86
Statistika të INSTAT	12	241
Gjithsej	125	3,474

Si çdo agjenci statistikore, Banka e Shqipërisë synon që, jo vetëm të realizojë me sukses hartimin dhe publikimin e treguesve statistikorë, por edhe të përmirësojë në vazhdimësi shërbimin ndaj publikut duke zgjeruar gamën e treguesve, duke përafuar metodologjinë me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare dhe duke ofruar informacionin në një mënyrë sa më të përshtatshme, për një rreth të gjerë dhe të larmishëm përdoruesish. Faqja e internetit e Bankës së Shqipërisë reflekton në mënyrë dinamike kërkesat cilësore dhe sasiore të përdoruesve dhe aktualisht përmban 125 tabela me 3,474 tregues. Aplikimet e hapësirës 'Statistika/Seri Kohore' i mundësojnë përdoruesve të marrin informacion mbi treguesit e sapopublikuar, kohën e publikimit dhe përmbajtjen e publikimit. Kërkimi mundëson zgjedhjen e periudhave, treguesve brenda tabelave dhe formës së shfaqjes së informacionit (për më shumë shiko aneksin 1). Një publikim mjaft i plotë dhe i vlerësuar nga përdoruesit është Raporti Statistikor Mujor i Bankës së Shqipërisë, i cili përmban jo vetëm statistika të sektorit monetar dhe atij të jashtëm, por edhe tregues të rëndësishëm të sektorit real dhe të sektorit fiskal, të publikuar përkatësisht nga INSTAT dhe Ministria e Financave.

VII.4.1. PRODHIMI STATISTIKOR

Gjatë vitit 2010, publikimi i statistikave monetare dhe statistikave të bilancit të pagesave nga ana e Bankës së Shqipërisë është bërë sipas afatit të shpallur në kalendarin e publikimit të statistikave. Për të respektuar afatin e publikimit, në rastet e vonesave të raportimit nga njësitë raportuese, Banka e Shqipërisë ka marrë masa për shkurtimin e kohës së përpunimit të informacionit. Publikimi i statistikave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë është bërë në formë elektronike në faqen zyrtare të institucionit, ndërkohë që Raporti Statistikor Mujor është shpërndarë pranë rreth 350 përdoruesve institucionalë në trajtë CD-je. Publikimet statistikore në letër janë përfshirë në raportet periodike të Bankës së Shqipërisë si Raporti Tremujor i Politikës Monetare dhe Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimi kryesor gjatë vitit 2010, në drejtim të prodhimit statistikor, është publikimi për herë të parë për publikun e gjerë i statistikave të borxhit të jashtëm bruto, statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe statistikave të detajuara të kredisë për ekonominë. Statistikat e borxhit të jashtëm bruto dhe statistikat e pozicionit të investimeve ndërkombëtare plotësojnë kategorinë e statistikave të sektorit të jashtëm së bashku me statistikat e bilancit të pagesave, të kursit të këmbimit dhe të rezervave valutore. Publikimi i këtyre statistikave sipas standardeve përkatëse, është kusht që kërkohet të plotësohet nga të gjitha vendet që anëtarësohen në Standardin

Special të Shpërndarjes së të Dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar, si edhe nga vendet anëtare ose që janë në procesin e aplikimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Tabelat statistikore për kredinë sipas subjekteve, monedhës, afatit të maturimit, aktivitetit ekonomik, qarkut etj. nuk janë të kërkuara nga standardet ndërkombëtare statistikore, por një numër i madh shtetesh i publikojnë për t'iu ardhur në ndihmë përdoruesve me informacion sa më të detajuar dhe me interes për ta. Gjatë vitit 2011, baza e të dhënave të publikuara të Bankës së Shqipërisë do të pasurohet me tabela të detajuara për depozitat e rezidentëve në sistemin bankar.

VII.4.2. AKTIVITETET STATISTIKORE NË HORIZONTIN AFATMESËM

Në periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë do të vijojë të prodhojë dhe publikojë statistika monetare dhe financiare dhe statistika të sektorit të jashtëm, në përputhje me manualet dhe praktikën ndërkombëtare⁷. Njëkohësisht, në rolin e saj si agjenci statistikore, Banka e Shqipërisë do të vijojë të japë kontribut aktiv në përmirësimin e sistemit statistikor kombëtar, duke përfshirë përforsimin e marrëdhënieve me agjencitë e tjera statistikore, pasurimin e bazës ligjore dhe rregullative për aktivitetet statistikore dhe hartimin e ndjekjen e planeve dhe programeve kombëtare për prodhimin statistikor me fokus të veçantë në kërkesat për raportimin statistikor të Bashkimit Evropian. Në kuadrin e përgatitjeve për plotësimin e kërkesave të Bashkimit Evropian në drejtim të statistikave të prodhuara nga bankat qendrore, Banka e Shqipërisë do të përfitojë nga Projekti i Binjakëzimit me bankat qendrore të dy vendeve të Bashkimit Evropian⁸. Për statistikën e sektorit monetar dhe të sektorit të jashtëm, gjatë kohëzgjatjes së këtij projekti do të punohet si në drejtim të përmirësimit të metodologjisë dhe formave të raportimit, ashtu edhe në drejtim të teknologjisë, praktikave të përpunimit dhe atyre të shpërndarjes së statistikave.

VII.4.3. MARRËDHËNIA ME PËRDORUESIT

Banka e Shqipërisë është në kontakt të vazhdueshëm me përdoruesit e rregullt të statistikave që ajo prodhon dhe publikon. Lista e shpërndarjes së publikimeve statistikore për përdoruesit institucionalë, rishikohet herë pas here me qëllim përfshirjen në të të gjithë përdoruesve të interesuar dhe institucioneve të reja. Në të njëjtën kohë, hapësira 'Statistika' në faqen e Bankës së Shqipërisë është në përmirësim të vazhdueshëm me qëllim përafrimin e formatit dhe përmbajtjes së publikimeve, me kërkesat e një baze të gjerë përdoruesish. Në muajin nëntor të vitit 2010, Banka e Shqipërisë organizoi takime me dy grupe të rëndësishme përdoruesish. Takimi i parë u bë me përfaqësues të shtypit dhe

⁷ Për statistikën e bilancit të pagesave dhe të pozicionit të investimeve ndërkombëtare - "Manuali i Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare", FMN, Edicioni i gjashtë, Janar 2010. Për statistikën e borxhit të jashtëm - "Statistikën e borxhit të jashtëm: udhërrëfyes për hartuesit dhe përdoruesit", FMN, Qershor 2003. Për statistikën monetare dhe financiare - "Manuali i Statistikave Monetare dhe Financiare", FMN, Tetor 2000.

⁸ Në Projektin e Binjakëzimit "Përforsimi i kapaciteteve institucionale të Bankës së Shqipërisë", asistencë do të ofrohet nga Banka e Italisë dhe Banka e Francës.

takimi i dytë me përfaqësues të përdoruesve institucionalë dhe akademikë. Të dy takimet u pritën me mjaft interes. Në këto takime u prezantuan grupet kryesore të statistikave të publikuara në faqen e Bankës së Shqipërisë dhe u dhanë udhëzime praktike mbi përdorimin e faqes. Gjatë takimeve u trajtuan pyetje dhe sugjerime të përdoruesve lidhur me metodologjinë, burimet e të dhënave, marrëdhëniet midis agjencive statistikore brenda vendit dhe aspekte të tjera të rëndësishme të statistikave zyrtare.

VII.5. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2010, përpjekjet e Bankës së Shqipërisë në kuadër të marrëdhënieve me publikun janë fokusuar kryesisht në rishikimin e mjeteve ekzistuese dhe ndërtimin e mënyrave të reja të komunikimit, të cilat ndihmojnë në përmbushjen e qëllimit afatgjatë, atë të krijimit të një ambienti me aktorë të mirinformuar dhe të aftë të kuptojnë vendimmarrjen e bankës qendrore dhe të marrin vendime racionale mbi çështjet ekonomike e financiare.

Për të arritur një informim gjithëpërfshirës, është bashkërenduar përdorimi i mjeteve të tilla si: komunikime të drejtpërdrejta të Guvernatorit në konferenca për shtyp, intervista dhe fjalime për çështje që kërkojnë vëmendjen e publikut; botime periodike dhe joperiodike që vënë në dispozicion të publikut informacione mbi punën e Bankës dhe procesin vendimmarrës të saj; faqja zyrtare e internetit e cila ofron në kohë reale informacion mbi aktivitetin e politikave të institucionit; si dhe edukimi financiar i publikut që synon të zhvillojë kulturën ekonomiko-financiare të shoqërisë shqiptare.

- *BOTIMET E BANKËS SË SHQIPËRISË*

Edhe gjatë vitit 2010, botimet e Bankës së Shqipërisë janë vënë në funksion të informimit të publikut rreth zhvillimeve më të fundit në ekonominë shqiptare dhe atë botërore, si dhe në sistemin financiar e bankar, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Ky vit ka sjellë disa ndryshime në setin e botimeve periodike të Bankës së Shqipërisë. Kështu, Deklarata e Politikës Monetare, pjesë e Buletinit Ekonomik, u publikua si botim më vete me titull "Raporti i Politikës Monetare", me periodicitet tremujor. Si rrjedhojë e rishikimit të Buletinit Ekonomik, u shtua një titull i ri në këtë set: Buletini i Bankës së Shqipërisë. Ky botim vjen te publiku çdo gjashtë muaj dhe risia e tij është editoriali hyrës, dedikuar projektit apo aktivitetit më madhor të Bankës për gjashtëmujorin në fjalë.

Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2010, Raporti i Stabilitetit Financiar ndryshoi periodicitet publikimi, nga një në dy herë në vit, ndërsa është punuar për sjelljen e Raportit Statistikor Muajor në një format të ri, më funksional e të pëlqyeshëm për përdoruesin.

- *MARRËDHËNIET ME MEDIAN*

Në vazhdim të një eksperience, tashmë të konsoliduar e pozitive, komunikimi i bankës qendrore me të gjitha organet e medias, edhe gjatë këtij viti, nuk ka reshtur së qeni një marrëdhënie e drejtpërdrejtë dhe intensive. Kështu, janë ndërmarrë iniciativa të reja, përmes të cilave synohet rritja e transparencës dhe e ndërgjegjësimit të publikut mbi rolin e Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar në ekonominë e vendit.

Boshti kryesor i komunikimit ka vijuar të jetë konferenca mujore për shtyp e Guvernatorit pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë përcillen tek media dhe publiku arsyet ekonomike e financiare në themel të vendimmarrjes së politikës monetare të radhës. Duke filluar që nga muaji korrik 2010, këtij boshti i janë shtuar edhe prezantimet në një formë më të thjeshtuar të raporteve të ndryshme periodike mbi politikën monetare, stabilitetin financiar, statistikat, mbikëqyrjen bankare etj. Këto prezantime shërbejnë për orientimin e mediave në leximin e drejtë të vendimeve dhe veprimtarisë së Bankës dhe për të përcjellë mesazhin e duhur te publiku.

- *EDUKIMI FINANCIAR I PUBLIKUT*

Duke patur parasysh klimën e përgjithshme ekonomike dhe natyrën gjithnjë e më komplekse të tregjeve financiare, të sistemit bankar shqiptar dhe të produkteve që bankat i ofrojnë qytetarëve të vendit tonë, rëndësia e edukimit financiar të publikut është, vit pas viti, në rritje të vazhdueshme.

Në këtë kuadër, gjatë muajit mars 2010, Banka e Shqipërisë organizoi një panel ndërkombëtar diskutimi mbi financat e përgjegjshme, në bashkëpunim me KfW Entwicklungsbank (Banka Gjermane e Zhvillimit) dhe Fondin Evropian të Mikrofinancës për Evropën Juglindore (EFSE). Gjatë këtij paneli, përfaqësues të sektorit financiar dhe qeverisë shqiptare, të agjencive donatore, të institucioneve financiare ndërkombëtare si dhe praktikues të mikrofinancës në Shqipëri, bënë thirrje për përpjekje më të mëdha për të promovuar praktikën dhe parimet e financës së përgjegjshme në Shqipëri. Siç do ta cilësonte dhe Guvernatori, financë e përgjegjshme është termi më i mirë për të përmbledhur në një emërtim të vetëm, përpjekjet e gjithanshme të Bankës së Shqipërisë gjatë 3-4 viteve të fundit në drejtim të mbikëqyrjes bankare dhe financiare, politikës monetare dhe edukimit të publikut.

Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, kanë synuar të jenë të barasvlershme me ato të bankave qendrore më të angazhuara në edukimin financiar, e të ecin në një linjë me zhvillimet si dhe me nevojat e publikut.

Kështu, një pjesë e madhe e vëmendjes sonë i është dedikuar programeve që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të ndryshme të interesit, të cilat kanë rezultuar të suksesshme në fazat e tyre pilot, duke i hapur kështu rrugë zhvillimit të tyre të mëtejshëm.

I krijuar në vitin 2007 për të promovuar ngritjen e një kulture ekonomike dhe financiare në shoqërinë shqiptare, programi "Banka qendrore në jetën

e përditshme” përfshiu gjatë vitit 2010 rrethet e Durrësit, Beratit dhe Fierit. Falë mbështetjes së Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR) të rretheve përkatëse dhe angazhimit të specialistëve të departamenteve të ndryshme të Bankës, u realizuan për mësuesit e lëndës së ekonomisë të arsimit të mesëm këto seminare trajnimi:

Tabelë 15. Seminaret e trajnimit të mësuesve të arsimit të mesëm.

Periudha e zhvillimit	Përshkrimi i seminarit	Pjesëmarrja
29 mars – 2 prill 2010	Seminar trajnimi në fushat e financës, ekonomisë dhe bankingut, për mësuesit e arsimit të mesëm të Durrësit	Mësues të gjimnazeve (30)
26 – 30 prill 2010	Seminar trajnimi në fushat e financës, ekonomisë dhe bankingut, për mësuesit e arsimit të mesëm të Beratit	Mësues të gjimnazeve (30)
24 – 28 maj 2010	Seminar trajnimi në fushat e financës, ekonomisë dhe bankingut, për mësuesit e arsimit të mesëm të Fierit	Mësues të gjimnazeve (33)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ashtu si në seminaret e zhvilluara në vitet e mëparshme, edhe në këto rrethe mësuesit pjesëmarrës u njohën jo vetëm me funksionet dhe rolin e institucionit të bankës qendrore, të sistemit bankar dhe atij financiar shqiptar, por edhe me tema të tjera si financat publike apo buxheti i shtetit.

Në eksperiencën e Bankës së Shqipërisë, por edhe të bankave të tjera qendrore, seminaret e trajnimit të mësuesve kanë treguar të jenë një mjet shumë efikas për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, duke ndikuar pozitivisht në edukimin e brezit të ri. Kontakti i drejtpërdrejtë me mësuesit e arsimit të mesëm krijon kushte për orientimin e tyre mbi broshura e materiale të ndryshme edukative të Bankës së Shqipërisë, të cilat mund t’i vijjnë në ndihmë gjatë procesit mësimdhënës.

Gjatë vitit 2010, seria e leksioneve të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në universitete ka vijuar në Universitetin “POLIS” dhe në Universitetin Evropian Juglindor të Tetovës. Duke dalë paksa jashtë boshtit klasik rreth të cilit janë ngritur aktivitete të kësaj natyre, në leksionin e mbajtur në Universitetin “POLIS”, Guvernatori Fullani trajtoi projektin e ndërtimit dhe rikonstruksionit të godinës qendrore të Bankës së Shqipërisë, si një ndërthurje e arkitekturës së ndërtesës ekzistuese me arkitekturën moderne, e cila përveç ruajtjes së vlerave arkitekturore, historike dhe kulturore, do të ofrojë edhe zgjidhje shumëfunksionale për nevojat e Bankës.

Takimet e Guvernatorit me nxënës të shkollave të mesme të qyteteve të ndryshme të vendit, kanë vijuar të përbëjnë një nga aktivitetet kryesore dedikuar të rinjve. Kështu, Guvernatori ka zhvilluar takime me nxënës të shkollave të mesme të qytetit të Beratit, Gjirokastrës dhe Shkodrës.

Gjatë një prej këtyre takimeve, Guvernatori lançoi edhe një nga projektet kryesore në fushën e edukimit të publikut, edukimin nëpërmjet faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë. Duke përfutur nga të gjitha kushtet favorizuese që ofrojnë zhvillimet më të fundit në teknologjinë e komunikimit, si dhe duke marrë parasysh që të rinjtë janë përdoruesit kryesorë të kësaj teknologjie, Banka e Shqipërisë ka punuar për të sjellë së shpejti një platformë të plotë

informuese mbi bankën qendrore, ekonominë dhe financat personale, e cila do të aksesohet tërësisht përmes internetit.

Një projekt madhor në fushën e edukimit është edhe hartimi i një moduli me zgjedhje të lirë dedikuar financave personale, për të cilin gjatë vitit 2010 Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar ngushtësisht me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA), në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Hartimi i këtij teksti ka mbledhur në një tryezë të përbashkët punonjës të Bankës së Shqipërisë, përfaqësues të Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe mësues të lëndës së ekonomisë. Moduli do të përfshihet në kurrikulat e vitit mësimor 2011-2012, duke i pajisur nxënësit e gjimnazeve me njohuri dhe aftësi mbi administrimin e parasë, hartimin e buxhetit, arritjen e objektivave financiarë, përdorimin e matur të kredisë, investimet, kursimet, sigurimet dhe taksat.

VII.6. INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI

• ÇËSHTJE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), pas ratifikimit të saj nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian, hyri në fuqi më datë 1 prill 2009, duke i hapur kështu Shqipërisë rrugën drejt aplikimit në Bashkimin Evropian për marrjen e statusit të vendit kandidat. Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian më datë 28 prill 2009 dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në Traktatin e BE-së, Komisioni Evropian i dorëzoi autoriteteve shqiptare një Pyetësor me qëllim vlerësimin e aftësisë së vendit për të përmbushur kriteret e anëtarësimit.

Duke u bazuar në përgjigjet e dhëna në Pyetësor nga autoritetet shqiptare, Komisioni Evropian më datë 9 nëntor 2010 publikoi Opinionin e tij në lidhje me aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Komisioni Evropian vlerësoi arritjet e Shqipërisë gjatë 12 muajve të fundit, por në lidhje me hapjen e negociatave për anëtarësim theksoi ende nevojën e reformave për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, veçanërisht atë të kriterit politik. Gjithashtu, në Opinion nënvizohet qartë perspektiva evropiane e vendit.

ANGAZHIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË PLOTËSIMIN E PYETËSORIT TË KE-SË

Pyetësori i KE-së përmbante 2284 pyetje, të ndara përkatësisht në 33 kapituj të *acquis communautaire* dhe 2 kapituj ku trajtohen veçanërisht kriteret e Kopenhagenit (kriteri politik dhe kriteri ekonomik).

Në përputhje me strukturën ndërinstitucionale të përcaktuar, Banka e Shqipërisë u caktua institucion koordinues për përgatitjen e përgjigjeve të:

- Kapitullit 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit", ku trajtohen çështjet në lidhje me kuadrin legjislativ dhe rregullativ të: lëvizjeve afatshkurtra dhe afatgjata

të kapitalit, kufizimeve ekzistuese dhe përcaktimin e llojeve të ndryshme të lëvizjeve të kapitalit; shërbimeve të pagesave, veçanërisht pagesave ndërkufitare, tregut të shërbimeve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike; parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë fushë.

- Kapitullit 17 “Politikat ekonomike dhe monetare”, ku trajtohen çështjet në lidhje me kuadrin legjislativ dhe rregullativ të: pavarësisë së bankës qendrore; ndalimit të financimit direkt të sektorit publik nga ana e bankës qendrore; ndalimit të aksesit të privilegjuar nga ana e sektorit publik në institucionet financiare; hartimit dhe zbatimit të politikës monetare dhe të kursit të këmbimit si dhe; përputhshmërisë me dispozitat e Traktatit të Bashkimit Evropian duke pasur parasysh perspektivën e adoptimit të monedhës euro.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ishte institucion kontribues për përgatitjen e përgjigjeve në kapitujt e mëposhtëm:

- Kapitulli “Kriteri ekonomik”
- Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”
- Kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”
- Kapitulli 28 “Mbrojta e konsumatorit dhe e shëndetit publik”
- Kapitulli 32 “Kontrolli financiar”
- Kapitulli 20 “Shoqëritë dhe politika industriale”

Pas dorëzimit të përgjigjeve të Pyetësorit në prill të 2010-s, Banka e Shqipërisë është angazhuar në dhënien e përgjigjeve të Pyetjeve Shtesë të dërguara nga Komisioni Evropian, si dhe në zhvillimin e takimit me Misionin Faktmbledhës të KE-së, ku u trajtuan çështjet në lidhje me përgjigjet e dhëna në Pyetësor.

Pas publikimit të Opinionit të KE-së mbi aplikimin e Shqipërisë në BE, Banka e Shqipërisë është në ndjekje të vazhdueshme të punës ndërinstitucionale në lidhje me adresimin e rekomandimeve të KE-së, në mënyrë që vendi të fitojë statusin e vendit kandidat, duke i hapur kështu rrugën procesit të negociatave për anëtarësim me BE.

Në përputhje me procesin e zbatimit të MSA-së, Banka e Shqipërisë ka kontribuar në rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për vitet 2010 – 2014. Në pjesën narrative të PKZMSA-së, kontributi i Bankës së Shqipërisë ka konsistuar në përshkrimin e zhvillimeve makroekonomike në vend gjatë vitit 2009, inflacionit dhe politikës monetare, ecurisë së sektorit bankar dhe sektorit të jashtëm të ekonomisë. Njëkohësisht, janë identifikuar dhe përditësuar përparësitë dhe masat e marra në fushat e stabilitetit makroekonomik, lëvizjes së lirë të kapitalit, të drejtës së vendosjes si dhe lirisë për të ofruar shërbime.

Në këtë kontekst, është realizuar parashikimi i nismave ligjore, rregullative, aktiviteteve zbatuese për realizimin e këtyre iniciativave, asistencës teknike të

nevojshme si dhe kostove të pritshme në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis*-në.

Banka e Shqipërisë ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integritimit Evropian, të cilës i ka përcjellë raporte mujore të progresit, duke pasqyruar progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në PKZMSA. Njëkohësisht, aktet ligjore dhe rregullative të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës janë shoqëruar me një relacion ku përshkruhet shkalla e përputhshmërisë së aktit me legjislacionin evropian.

Më datë 9 nëntor 2010, Komisioni Evropian publikoi Raportin Analitik për Shqipërinë, shoqëruar edhe me Opinionin e KE-së mbi aplikimin e Shqipërisë. Këto dy dokumente përshkruajnë progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës 30 tetor 2009 – 1 nëntor 2010 dhe sfidat me të cilat përballet ajo, duke skicuar njëkohësisht edhe përjasjen e Komisionit Evropian, për të udhëhequr dhe mbështetur vendin tonë në të ardhmen. Raporti Analitik përshkruan marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, analizon progresin e realizuar në drejtim të kriterëve politike, ekonomike dhe ligjore të anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit), si dhe bën një përmbledhje të vlerësimit të Komisionit Evropian mbi përparësitë dhe problematikat në 33 fushat e ndara sipas *acquis communautaire*.

Për çështjet në lidhje me veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, Komisioni Evropian në Raportin Analitik evidentoi se: “Politikat e përshtatshme fiskale dhe monetare kanë qenë ankorat kryesore për koordinimin e politikave dhe përbëjnë themelet për stabilitetin makroekonomik në Shqipëri. Kuadri i politikës monetare ka ankoruar pritjet inflacioniste, pavarësisht kufizimeve që kanë ardhur si pasojë e euroizimit të lartë. Regjimi fleksibël i kursit të këmbimit ka mbështetur rregullimet ndaj goditjeve nga jashtë.”

Gjatë vitit 2010, Banka e Shqipërisë ka përgatitur dhe prezantuar informacionet e kërkuara në takimet periodike midis Shqipërisë dhe BE-së. Kështu, në takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit u trajtuan të gjitha arritjet në drejtim të zbatimit të MSA-së, një vit pas hyrjes në fuqi të saj.

Ky takim përmbledhi të gjitha çështjet e diskutuara në nivel teknik në nënkomitetet e përbashkëta si ato të kriterit ekonomik dhe standardeve evropiane. Në përputhje me rekomandimet e nënkomitetit për Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, u raportua edhe në lidhje me masat e ndërmarra në drejtim të monitorimit prudencial të kredive me probleme si dhe në drejtim të masave të ndërmarra për reduktimin e përdorimit të parasë fizike (*cash*) në ekonomi.

Në takimin e dytë të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, Banka e Shqipërisë ka raportuar në lidhje me çështje si: zhvillimi i përgjithshëm ekonomik dhe perspektiva, inflacioni dhe politika monetare, sektori i jashtëm, marrëdhëniet me institucionet financiare ndërkombëtare, zhvillimet dhe reformat në sektorin financiar bankar.

Në përfundim të takimit të nënkomitetit për Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, delegacioni i KE-së vlerësoi punën e bërë në sektorin bankar duke u shprehur se të dhënat e ekonomisë shqiptare janë optimiste. Njëkohësisht, pala komunitare theksoi se lidhur me inflacionin dhe politikat monetare vlen të evidentohet mirëqeverisja e Bankës së Shqipërisë.

Në takimin e dytë të Nënkomitetit BE-Shqipëri mbi Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën është raportuar mbi punën e Bankës së Shqipërisë në lidhje me përmirësimin e kuadrit rregullator të sistemit bankar dhe atij të lëvizjes së kapitalit. Në përfundimin e këtij takimi, delegacioni i KE-së përshëndeti zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe rritjen e kapaciteteve administrative të Bankës së Shqipërisë.

Viti 2010 shënoi fillimin e zbatimit të projektit të binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me një ose dy banka qendrore anëtare të SEBQ-së të financuar nga Instrumenti i Paraaderimit (IPA) 2008 i BE-së, i cili synon forcimin e kapaciteteve institucionale në 6 fusha të veprimtarisë së Bankës, të ndara përkatësisht në 6 module: mbikëqyrja bankare dhe stabiliteti financiar, statistikat, sistemet e pagesave, tregu ndërbankar i parasë, edukimi financiar dhe koordinimi i integritetit evropian.

Kështu, pas përzgjedhjes së bankave binjakëzuese, përkatësisht Banka e Italisë në partneritet me Bankën e Francës, nënshkrimi i kontratës u realizua në muajin tetor, duke shënuar kështu fillimin e zbatimit të projektit të binjakëzimit. Gjatë kësaj periudhe, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë kanë realizuar disa takime parapërgatitore me ekspertë të Bankës së Italisë dhe Bankës së Francës me qëllim hartimin e Planeve të Zhvillimit për zbatimin e secilit modul. Në këto takime ka qenë i pranishëm edhe Këshilltari i Përhershëm i Projektit të Binjakëzimit (Resident Twinning Advisor), detyra kryesore e të cilit është koordinimi i të gjitha aktiviteteve të Projektit gjatë 18 muajve të parashikuara për zbatimin e tij.

Takimet në kuadër të hartimit të Planeve të Zhvillimit për secilin modul (implementimi i Komponentit të Parë të Projektit), duke përfshirë edhe ato të zhvilluara në fundvitin 2010 kanë pasur për qëllim evidentimin e situatës ekzistuese, në drejtim të kuadrit rregullator, infrastrukturor, kapaciteteve njerëzore dhe kryerjen e analizës së përmirësimeve të nevojshme me qëllim adoptimin e mëtejshëm të standardeve evropiane në secilin modul.

- *BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR*

Republika e Shqipërisë është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar që prej muajit tetor të vitit 1991. Kuota e saj gjatë vitit 2010 mbeti e pandryshuar, në shumën prej 48.7 milionë SDR, ashtu si edhe votat e saj (737 vota ose 0.03% e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së). Shqipëria ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën, San Marinon dhe Timorin Lindor. Kjo konstituencë ka një total prej 90.968 votash (ose rreth 4.1% e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së) dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian z. Arrigo Sadun, i cili shërben si Drejtor Ekzekutiv i konstituencës.

Në periudhën shkurt – mars, një mision i FMN-së kreu konsultimet në kuadër të Nenit IV të Neneve të Marrëveshjes së FMN-së. Mbi bazën e vlerësimeve të misionit, Bordi Ekzekutiv i FMN-së, në datën 24 maj 2010, konkludoi konsultimet në kuadër të Nenit IV të Neneve të Marrëveshjes së FMN-së. Sipas vlerësimeve, stimuli i fortë i politikave ekonomike bëri që të zbuteshin goditjet e krizës botërore dhe që Shqipëria të përballonte krizën mjaft mirë. Si misioni, ashtu edhe Bordi Ekzekutiv vlerësuan punën e bërë nga Banka e Shqipërisë lidhur me politikën monetare, ankorimin e pritshmërive për inflacionin, ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar dhe atij makroekonomik etj.

Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2010, përkatësisht në muajt korrik dhe nëntor, Shqipëria u vizitua edhe nga dy misione të FMN-së, gjatë të cilave u diskutua me autoritetet shqiptare për zhvillimet e fundit ekonomike në vend, perspektivat e tyre në të ardhmen e afërt dhe të largët si dhe rolin e politikave strukturore e makroekonomike për nxitjen dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka përfaqësuar rregullisht Republikën e Shqipërisë në vendimmarrjen e Bordit të Guvernatorëve, i cili është dhe organi më i lartë i FMN-së. Një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet me FMN-në gjatë këtij viti, kanë zënë edhe mbledhjet e pranverës dhe ato vjetore të FMN-së dhe të Bankës Botërore, të organizuara përkatësisht në muajt prill dhe tetor, ku delegacioni i Bankës së Shqipërisë, i kryesuar nga Guvernatori, ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë të FMN-së. Këto takime u përqendruan në zhvillimet më të fundit makroekonomike si dhe masat e marra nga ana e Bankës së Shqipërisë për minimizimin e efekteve të krizës botërore.

Gjatë takimeve janë evidentuar marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet FMN-së dhe autoriteteve shqiptare si dhe është vlerësuar puna e bërë nga ana e Bankës së Shqipërisë në menaxhimin e situatës së krijuar nga efektet e krizës. Përfaqësuesit e lartë të FMN-së kanë shprehur gatishmërinë për të vazhduar projektet e ndihmës teknike për Bankën e Shqipërisë.

Shqipëria gjithashtu i pagoi FMN-së gjatë vitit 2010 rreth 8.1 milionë SDR në kuadër të shlyerjeve të detyrimeve (pagesa principali, interesa, shpenzime periodike etj.), të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e kaluara PRGF dhe PRGF/ EFF.

Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2010 ka vazhduar të përfitojë nga asistencë teknike e FMN-së, në lidhje me trajnimin e stafit të saj duke përfutur konsulencë në fusha të tilla si politika monetare dhe mbikëqyrja bankare.

- *MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE*

Shqipëria është anëtare e Grupit të Bankës Botërore që prej vitit 1991 dhe ka përfituar nga ky institucion një total fondesh prej rreth 1.4 miliardë dollarë për 68 projekte. Në datën 15 korrik 2010, Bordi i Drejtorëve të Grupit të Bankës

Botërore miratoi strategjinë e re trevjeçare të partneritetit me Shqipërinë, e cila do të përqendrohet në tre objektiva strategjike që janë: (i) mbështetja në rritjen e nivelit të rritjes ekonomike të Shqipërisë përmes përmirësimit të kushteve të konkurrueshmërisë, (ii) zgjerimi dhe mbështetja e përfitimeve sociale përmes përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore, si dhe (iii) reduktimi i ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të një vizite zyrtare që zhvilloi në Shqipëri në muajin janar, Zëvendës-presidenti i Bankës Botërore për Evropën dhe Rajonin e Azisë Qendrore, z. Philippe Le Houérou zhvilloi një takim të veçantë me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, gjatë të cilit u diskutua për situatën makroekonomike në vend dhe projektet e ardhshme të bashkëpunimit.

Edhe gjatë vitit 2010, bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Grupin e Bankës Botërore vazhdoi në kuadrin e marrëveshjes "Për administrim dhe konsulencë të investimit të rezervës valutore", të nënshkruar në muajin shtator 2005. Kjo konsulencë dhe asistencë teknike është konkretizuar nëpërmjet vizitave të ekspertëve të Thesarit të Bankës Botërore si dhe pjesëmarrjes së punonjësve të Bankës së Shqipërisë në seminare të organizuara nga Banka Botërore jashtë vendit. Asistenca e ofruar nga ekspertët e Bankës Botërore gjatë këtyre viteve ka qenë shumë e dobishme, duke kontribuar në ngritjen në një nivel të ri të aktiviteteve të realizuara nga Banka e Shqipërisë për qëllime të administrimit të rezervës valutore. Kështu, gjatë vitit 2010 Banka e Shqipërisë është vizituar nga 3 misione të Bankës Botërore të cilat janë përqendruar në çështje të tilla si negociimi i kontratave për qëllime të procesit të administrimit të rezervës valutore, përdorimi i instrumentit *covered forwards* për qëllime të administrimit të portofolit të instrumenteve afatshkurtra dhe funksioni i kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu, gjatë vitit 2010 Banka Botërore ka ofruar asistencë teknike edhe në kuadër të një projekti për planet e kontigjencës dhe simulimin e situatave të krizës financiare. Misioni i Bankës Botërore ka zhvilluar takime dhe diskutime intensive jo vetëm me stafin e Bankës së Shqipërisë, por edhe me stafin e institucioneve të tjera si Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Në takimet e zhvilluara nga ana e delegacionit të Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e lartë të Grupit të Bankës Botërore në kuadër të mbledhjeve të pranverës dhe atyre vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore janë trajtuar gjerësisht zhvillimet makroekonomike të vendit, zhvillimet e sistemit bankar dhe financiar si dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Bankës Botërore kanë shprehur mbështetjen e tyre për hapat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë si dhe kanë ofruar asistencë në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës financiare. Në të gjitha takimet, janë vlerësuar marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit midis dy institucioneve si dhe është diskutuar rreth intensifikimit të mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.

Banka Botërore vazhdimisht ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar Bankën e Shqipërisë në zbatimin e projekteve që kanë për qëllim final

konsolidimin, modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar.

- *MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA FINANCIARE*

NDËRKOMBËTARE

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2010 ka vijuar të mbajë kontakte të vazhdueshme edhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe në sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2009, BERZH-i vlerësoi zhvillimet dhe rregullimin e duhur të sektorit financiar si dhe ndërhyrjet monetare që ndihmuan në kufizimin e ndikimeve të krizës financiare globale. Raporti, gjithashtu vlerësoi shumë pozitivisht kuadrin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbajtjen e inflacionit brenda objektivave si dhe forcimin e mbikëqyrjes bankare.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka vazhduar mbajtjen e marrëdhënieve të ngushta edhe me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) gjatë vitit 2010. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë në Mbledhjen e 80^{të} Vjetore të BIS-it të zhvilluar në muajin qershor në Bazel të Zvicrës, ku në takimet e zhvilluara me përfaqësues të këtij institucioni dhe të bankave të tjera anëtare është vënë theksi tek rëndësia e thellimit të bashkëpunimit teknik ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të tjera qendrore në fushat e interesit të përbashkët. BIS-i ka qenë veçanërisht aktiv në ofrimin e asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga Instituti i Stabilitetit Financiar, i cili promovon stabilitetin financiar ndërkombëtar përmes shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes së sistemit financiar.

- *MARRËDHËNIET ME BANKAT QENDRORE DHE BASHKËPUNIMI TEKNIK*

Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me bankat e tjera qendrore, gjatë vitit 2010, me ftesë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë kanë zhvilluar vizita zyrtare në Shqipëri Guvernatori i Bankës Kombëtare të Serbisë, ish-Guvernatori i Bankës Kombëtare të Zvicrës dhe Zëvendësguvernatori i Bankës Kombëtare të Suedisë, ndërsa janë zhvilluar disa vizita zyrtare të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë pranë Bankës së Greqisë, Bankës së Rusisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë edhe në shumë konferenca ndërkombëtare, samite dhe seminare rajonale, ku veçohen samiti i dytë vjetor i Ministrave të Financave dhe Guvernatorëve të Bankave Qendrore të vendeve të Evropës Juglindore, konferenca Rajonale mbi Financat dhe Investimet për Evropën Juglindore të organizuar nga Euromoney, konferenca "Financa të Përgjegjshme" organizuar nga KfW Entwicklungsbank, Fondi Evropian i Mikrofinancës për Evropën Juglindore (EFSE) dhe Banka e Shqipërisë, tryeza e dialogut "Forcimi i ankorave të brendshme në ndihmë

të strategjive të daljes nga kriza” organizuar nga Qendra e Ekselencës në Financë (Center of Excellence in Finance) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, tryeza e rrumbullakët “Sfidat ekonomiko-politike të bashkëpunimit rajonal” organizuar nga Universiteti i Oksfordit dhe Banka e Shqipërisë, seminari i gjashtë Euro-Mesdhetar i Bankave Qendrore të Eurosishtemit dhe Mesdheut, seminari i nivelit të lartë “Forcimi i mbikëqyrjes mikro dhe makroprudenciale” në kuadër të Europrogramit, etj.

Këto takime, vizita dhe konferenca kanë shërbyer jo vetëm për shkëmbimin e eksperiencave, analizimin e zhvillimeve ekonomike apo masat e marra në kuadër të krizës financiare botërore, por edhe për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit teknik gjithnjë e në rritje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve homologe.

Në planin rajonal, vlen të theksohet pjesëmarrja në takimet e Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Detit të Zi, Azisë Qendrore dhe Ballkanit, takime të cilat kanë si qëllim të forcojnë lidhjet midis bankave qendrore të rajonit dhe të nxisin bashkëpunimin rajonal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës më të mirë e trajtimit në tryeza të rrumbullakëta në nivel guvernatorësh ose ekspertësh të çështjeve aktuale. Po në këtë plan vlej të theksohen takimet në kuadër të Memorandumit shumëpalësh të Mirëkuptimit, të cilat synojnë rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm në fushën e mbikëqyrjes bankare në Evropën Juglindore dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në rajon; takimet në kuadër të Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore, i cili është një forum për dialog diplomatik dhe politik midis shteteve, ku këtë vit paneli i Guvernatorëve të Bankave Qendrore dhe Rregullatorëve të Sektorit Bankar, pati në fokus diskutimin e treguesve makroekonomikë dhe zhvillimet e sektorit financiar në mjedisin e ndikuar nga kriza.

Në muajin maj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mori pjesë në takimin e 17-të të Guvernatorëve të bankave qendrore të vendeve frankofone, takim i cili u përqendrua në sfidat politike dhe reformimin e axhendës pas krizës, përvojat e vendeve të veçanta dhe masat stimuluese të ndërmarra si pasojë e krizës, strategjitë që do të përdoren për daljen nga kriza dhe rolin e bankave qendrore në ruajtjen e stabilitetit financiar, ruajtjen e pavarësisë së bankës qendrore në të ardhmen, si dhe zhvillimin ekonomik të vendeve anëtare.

Ndërkohë, në muajin dhjetor, me rastin e prezantimit të raportit të parë të stabilitetit financiar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQRK), Guvernatori i Bankës së Shqipërisë zhvilloi një vizitë zyrtare dhe mbajti një fjalim në konferencën e organizuar me këtë rast. Në takimet e zhvilluara me drejtuesit e BQRK-së, u vlerësuan jo vetëm marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit midis dy institucioneve, por u shpreh edhe gatishmëria për vazhdimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi teknik.

Si në vitet e kaluara ashtu edhe gjatë vitit 2010, në funksion të bashkërendimit të asistencës teknike përparësi ishte dhe ofrimi i ekspertizës teknike për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQRK) nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kështu, janë realizuar disa vizita pune të delegacioneve të BQRK-së pranë

Bankës së Shqipërisë dhe anasjelltas, të përqendruara në fusha si kontrolli i brendshëm, sistemet e pagesave, mbikëqyrja, administrimi, etj.

Gjatë vitit 2010, Banka e Italisë, Banka Kombëtare e Bullgarisë, Banka Qendrore e Republikës së Turqisë, Banka e Francës dhe Center of Excellence in Finance (CEF) kanë qenë ofrueset kryesore të asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet organizimit të vizitave të punës apo *internship*-eve.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të protokollit të bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Serbisë, gjatë vitit 2010 janë organizuar vizita të ndërsjella pune dhe *internship*-e, të cilat kanë shërbyer për shkëmbimin e eksperiencave për çështje me interes të përbashkët në fusha të ndryshme të bankingut qendror.

VII.7. NDRYSHIMET KRYESORE NË LEGJISLACIONIN BANKAR GJATË VITIT 2010

Edhe gjatë vitit 2010, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe në përshtatje me dinamikën më të fundit të zhvillimeve në vend. Në vijim do të gjeni një përmbledhje të ndryshimeve më të rëndësishme ligjore dhe nënligjore në fushën bankare të hartuara gjatë vitit 2010.

I. Akte ligjore në fushën e sistemit të pagesave

Në funksion të sigurisë dhe eficiencës së sistemit të pagesave, në fund të vitit 2010, Banka e Shqipërisë përfundoi hartimin e projektligjit "Për sistemin e pagesave", i cili është dërguar pranë Ministrisë së Financave. Projektligji paraqet një harmonizim të plotë me parimet themelore të direktivave të BE-së në fushën e sistemeve të pagesave dhe veçanërisht me Direktivën 98/26/EC për finalitetin e pagesave në sistemet e pagesave dhe të titujve, Direktivën 2002/47/EC për rregullimin e kolateralit financiar dhe me parimet kryesore të Komitetit të Bazelit për sistemet e pagesave me rëndësi sistemike.

II. Përmirësimi i kuadrit rregullativ mbi mbikëqyrjen e veprimtarive të bankave dhe institucioneve financiare jobanka

Aktet e reja rregullative për mbikëqyrjen bankare të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2010 janë:

1. Rregullorja nr. 25, datë 24.03.2010 "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve jobanka".

Ky akt rregullativ përcakton rregullat për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve jobanka me qëllim ushtrimin në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme të veprimtarive financiare nga këto subjekte. Më konkretisht, kjo rregullore përcakton kriteret për administrimin e rrezikut

nga subjektet jobanka, si dhe vendos detyrimin që këto subjekte të hartojnë metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve në përputhje me aktet e brendshme të subjektit dhe aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë. Rregullorja përcakton treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut/qeve, si dhe kufijtë e ekspozimit maksimal të lejueshëm që duhen respektuar nga këto subjekte.

Gjithashtu, rregullorja përcakton normat për administrimin e rrezikut lidhur me pozicionet e hapura valutore, për rrezikun e likuiditetit dhe për rrezikun e kredisë. Lidhur me këtë të fundit, rregullorja përcakton kriteret për klasifikimin e kredive, detyrimin për krijimin e fondeve përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive, për ristrukturimin e kredive si dhe për fshirjen e kredive të humbura, duke parashikuar rregullime të veçanta për institucionet e mikrokredisë dhe subjektet financiare që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare. Rregullorja përcakton edhe detyrimet për raportim dhe masat mbikëqyrëse ndaj subjekteve jobanka, në rast të mosrespektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Rregullorja Nr. 48, datë 14.07.2010 “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”.

Kjo rregullore shfuqizon dhe zëvendëson rregulloren e mëparshme “Për pozicionet e hapura valutore”, miratuar me vendim nr. 59, datë 05.05.1999 të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar, dhe udhëzimi metodik “Për rreziqet nga këmbimet valutore” i datës 26.06.1999. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe kriterëve për llogaritjen, raportimin dhe mbikëqyrjen e pozicioneve të hapura valutore të bankave, me qëllim administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit nga bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Ky akt nënligjor rregullon mënyrën e përcaktimit të pozicioneve të hapura valutore, kufijtë e lejueshëm të lidhur me to, si dhe administrimin e rrezikut që rrjedh nga pozicionet e hapura valutore. Lidhur me këtë të fundit, rregullorja përcakton detyrimin e bankave për krijimin e sistemit të administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit ndaj të cilit ajo ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku.

Gjithashtu, rregullorja vendos detyrimin e bankave për të hartuar politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit.

Lidhur me administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore, rregullorja përcakton përgjegjësitë e këshillit drejtues dhe të drejtorisë lidhur me hartimin e politikës për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit, me hartimin dhe aplikimin e procedurave për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të kursit të këmbimit të bankës në përputhje me politikën për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit; duke parashikuar dhe ngritjen e një strukture të posaçme si Komiteti/struktura e administrimit të rreziqeve, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e sistemit dhe politikave të lartpërmendura. Rregullorja përcakton dhe kërkesat monitoruese, raportuese dhe mbikëqyrëse për bankat, në lidhje me respektimin e detyrimeve që lindin prej saj.

3. Rregullorja nr.67, datë 13.10.2010 “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”.

Kjo rregullore zëvendëson rregulloren e mëparshme “Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” miratuar me vendimin nr. 38, datë 18.07.2007, e ndryshuar, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Objekti i saj është përcaktimi i përmbajtjes së informacionit, parimeve dhe rregullave për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushteve dhe kriterëve për njohjen dhe përdorimin e informacionit që administrohet në të. Rregullorja parashikon se Regjistri i Kredive që mbahet dhe administrohet nga Banka e Shqipërisë, funksionon si një sistem që trajton dhe shpërndan në mënyrë të centralizuar informacion në lidhje me kredimarrësit, personat e lidhur me ta dhe garantuesit e marrëveshjeve të kredisë, në funksion të ushtrimit të procesit të mbikëqyrjes dhe administrimit optimal të rrezikut të kredisë nga bankat dhe subjektet financiare jobanka. Kjo rregullore, në ndryshim nga rregullorja e mëparshme, zgjeron rrethin e raportuesve të të dhënave, duke përfshirë në të jo vetëm bankat dhe degët e bankave të huaja, por dhe subjektet financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera financiare, mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura nga Banka e Shqipërisë me to dhe/ose autoritetet e tyre mbikëqyrëse.

Përveç sa më sipër, rregullorja sanksionon dhe disa parime të rëndësishme, mbi bazën e të cilave funksionon Regjistri i Kredive, siç janë:

- përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave/informacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të dhënat personale, të sekretit profesional dhe atij bankar,
- funksionimi i këtij regjistri si shërbim publik që trajton dhe shpërndan informacion në lidhje me rrezikun e kredisë, pa kryer vlerësime në lidhje me këtë të fundit,
- mosmbajtja përgjegjësi nga Banka e Shqipërisë mbi mënyrën e përdorimit dhe vlerësimit të informacionit që shpërndan ky regjistër.

Rregullorja përkufizon dhe përmbajtjen e informacionit të Regjistrit të Kredive, duke parashikuar se në të raportohen, mbahen dhe përpunohen të dhëna/informacion në lidhje me identitetin, gjendjen e kreditit dhe ekspozimin kreditor të të gjithë kredimarrësve të raportuesve të të dhënave, për personat e lidhur me ta, si dhe për garantuesit e kredisë. Ky informacion përcaktohet në përputhje me kriteret dhe kategoritë për kreditë, aktivet e tjera si dhe zërat jashtë bilancit, të parashikuara në rregulloret për administrimin e rrezikut të kredisë, të Bankës së Shqipërisë.

Rregullorja parashikon dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive, duke parashikuar se ky regjistër synon të sigurojë përqendrimin e informacionit/të dhënave lidhur me ekspozimin kreditor të kredimarrësve në lidhje me vlerësimin e rrezikut të kredisë; mbështetjen e funksionit mbikëqyrës dhe rregullator të Bankës së Shqipërisë; si dhe përdorimin dhe/ose publikimin e informacionit të këtij regjistri nga Banka e Shqipërisë për

qëllime kërkimore, statistikore dhe qëllime të tjera të lidhura me procesin mbikëqyrës.

Gjithashtu, rregullorja përcakton dhe afatet dhe periodicitetin e raportimit të të dhënave në Regjistrin e Kredive, përgjegjësinë e raportuesve të të dhënave në lidhje me saktësinë e informacionit që raportojnë në regjistër, kushtet dhe mënyrat e përpunimit të informacionit që mbahet në Regjistër, si dhe parimet mbi bazën e të cilave ushtrohet e drejta e njohjes dhe e rishikimit të të dhënave/informacionit që mban Regjistri.

Rregullorja parashikon dhe detyrimet e raportuesve të të dhënave që lindin nga pjesëmarrja e tyre në sistemin e Regjistrin të Kredive, si dhe masat ndëshkimore që merr Banka e Shqipërisë ndaj raportuesve të të dhënave, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje.

4. Udhëzimi nr.68, datë 13.10.2010 "Për procedurën e nxjerrjes së raportit të kredimarrësit dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive", i cili zëvendëson udhëzimin "Për procedurën e nxjerrjes së Raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 71, datë 18.07.2007, i ndryshuar.

Udhëzimi përcakton procedurën për nxjerrjen e raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive.

Më konkretisht, ky udhëzim specifikon rregullat procedurale në lidhje me ushtrimin e të drejtës së njohjes dhe/ose të rishikimit të informacionit që mbahet dhe administrohet në Regjistrin e Kredive, të parashikuar nga rregullorja "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrin të Kredive në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.67, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Kjo e drejtë mund të ushtrohet sipas rastit nga vetë kredimarrësi, personat e lidhur me të ose trashëgimtarët e tyre, nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tyre, si dhe nga subjekte të tjera që gëzojnë të drejtën për të kërkuar raportin për kredimarrësin në bazë të një detyrimi ligjor apo vendimit të gjykatës kompetente.

Në ndryshim nga udhëzimi i mëparshëm, që parashikonte mundësinë e paraqitjes së kërkesës dhe tërheqjen e raportit të kredimarrësit vetëm në zyrat qendrore të Bankës së Shqipërisë, ky udhëzim parashikon dhe mundëson që paraqitja e kërkesës dhe e dokumenteve shoqëruese, si dhe tërheqja e raportit të kredimarrësit të kryhet jo vetëm pranë zyrave qendrore të Bankës së Shqipërisë, por dhe në degën më të afërt të Bankës së Shqipërisë ku subjekti ka paraqitur kërkesën.

Rregullorja parashikon se Banka e Shqipërisë mban një regjistër në të cilin evidentohen të gjitha kërkesat e dorëzuara për nxjerrjen e raportit të kredimarrësit dhe rishikimin e të dhënave, si dhe masat përkatëse në rast të mostrajtimit të kërkesës për rishikimin e të dhënave.

5. Udhëzimi nr. 70, datë 13.10.2010 "Mbi funksionimin e Regjistrin të

Kredive në Bankën e Shqipërisë”, i cili zëvendëson udhëzimin “Mbi rregullat e brendshme të funksionimit të Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” nr. 41, datë 27.05.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi në mënyrë të harmonizuar i funksioneve, detyrave dhe procedurave të brendshme operacionale që përmbushin dhe realizojnë njësi organizative të caktuara të Bankës së Shqipërisë, për administrimin, funksionimin, monitorimin dhe kontrollin e sistemit të Regjistrit të Kredive. Kjo për arsye se Banka e Shqipërisë, në përputhje me rregulloren “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.67, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është autoriteti përgjegjës për administrimin e sistemit të Regjistrit të Kredive.



"Vizatim i përdorur për kartëmonedhën 500 lekë emetim i vitit 1992."

